

„Kompetent gjuhësor që nga fillimi“ – Fleta udhëzuese U7a

Këshilla për praktikimin e shumëgjuhësisë në familje

Të dashur prindër,

tanimë fëmija Juaj është një „fëmijë kopshti“. Juve si prindër kjo Ju vë para një sfidë të re. Nëse fëmija Juaj ende nuk flet gjermanisht, Ju ndoshta do të mër-ziteni se a do të mund të gjendet ai me fëmijët e tjerë apo a do ta kuptojnë fëmijën Tuaj edukatoren. Kjo edhe për fëmijën Tuaj është një hap i madh, kështu që ai në këto momente ka nevojë për një mbështetje të posaçme.

Në vazhdim lexoni këshillat e rëndësishme për praktikimin/kontaktin me gjuhët e ndryshme në familje dhe në kopshtin për fëmijë.

Nëse fëmija Juaj deri më tani është rritur pothuajse vetëm me gjuhën e familjes

■ *Bisedoni/konsultohuni me edukatoren e fëmijës Tuaj.*

Fëmija Juaj me gjasë do të kuptojë gjermanisht pak dhe do t'i flasë vetëm disa fjalë të caktuara gjermane. Lidhur me këtë konsultohuni me edukatoren e fëmijës Tuaj, që këto fëmijës Tuaj të mund t'i ofrojnë mbështetje përkatëse.

■ *Fëmija Juaj duhet të shkojë rregullisht në kopshtin për fëmijë dhe atje të krijojë miqësi me fëmijët që flasin gjermanisht.*

Në këtë mënyrë fëmijës Tuaj i ofrohen shanse të volitshme për ushtrimin/mësimin e gjuhës gjermane. Prandaj përkraheni fëmijën Tuaj edhe atëherë kur ai pasdite dëshiron të takohet me fëmijët që flasin gjermanisht. Këto janë shembuj shumë të mirë për mësimin e gjuhës gjermane.

■ *Kur e sjellni apo e merrni fëmijën, flisni me edukatoren shkurt disa fjalë në gjermanisht.*

Kështu fëmija Juaj do ta vërejë se gjermanishtja edhe për Ju është e rëndësishme. Respektimi i të dy gjuhëve e përcakton në mënyrë vendimtare se sa mirë dhe sa me dëshirë fëmija Juaj do t'i mësojë gjuhët e caktuara.

■ *Nëse Ju vetë gjermanishten e flisni dobët, atëherë shfrytëzoni rastin që*

me fëmijën Tuaj bashkërisht të mësoni gjermanisht.

Në qoftë se fëmija Juaj rritet me më shumë gjuhë

■ *Mos u shqetësoni nëse fëmija Juaj momentalisht bën më shumë përparime në gjermanisht, madje edhe nëse ai eventualisht e favorizon gjuhën gjermane.*

Fëmijët shpesh e zgjedhin një gjuhë, me të cilën ata fillojnë të flasin. Gjuha e favorizuar me kalimin e kohës së rish mund të zëvendësohet. Në këto faza mos kërkoni nga fëmija Juaj që ai të flasë në gjuhën Tuaj amtare. Ju, sidomos në shtëpi, vazhdoni edhe më tej të flisni në gjuhën Tuaj amtare. Në të njëjtën kohë tregoni fëmijës Tuaj se jeni shumë i gëzuar me përparimet e tij në gjuhën gjermane.

■ *Mos u shqetësoni nëse fëmija Juaj i përziën gjuhët.*

Kjo ndodh shpesh dhe është krejtësisht normale. Fjalët ose strukturat gramatikore të cilat në njërin gjuhë nuk i ka ditur aq mirë sa duhet, tani ato do t'i zëvendësojë në gjuhën tjetër. Kjo nuk është arsye pse të brengoseni nëse fë-

mija ngatërrohet kur i zotëron mirë të dy gjuhët.

Në qoftë se brengoseni lidhur me zhvillimin gjuhësor të fëmijës Tuaj:

Konsultohuni me pediatrin Tuaj. Ai në rastin e dhënë do të iniciojë kontrollë të mëtejshme për të vendosur se a është e nevojshme një përkrahje apo një terapi gjuhësore. Me këtë rast është vendimtare se sa mirë flet fëmija Juaj në gjuhën e vet amtare. Nëse dëshmohet se fëmija Juaj ka vështirësi vetëm me gjermanishten, kjo me gjasë tregon se fëmija Juaj ende nuk ka pasur kontakte të mjaftueshme me gjermanishten. Një mbështetje specifike do t'i ndihmojë fëmijës Tuaj që t'i kompensojë shpejt ato që i kanë mbetur prapa.

Po që se fëmijës Tuaj i shfaqen probleme edhe në gjuhën amtare, atëherë mund të bëhet fjalë për një shqetësim në zhvillimin gjuhësor.

Kjo dukuri shfaqet pothuajse shpesh sikur te fëmijët që janë rritur me një gjuhë, po ashtu edhe te ata me më shumë gjuhë. Shumëgjuhësia nuk është shkak për shqetësimet në zhvillimin gjuhësor. Në këtë rast terapia gjuhësore ofron mbështetje optimale.

Pra, fëmija Juaj mund ta bëjë këtë

Fëmijët trevjeçarë disponojnë me një leksik (vokabular) të madh dhe formojnë fjali prej 4 deri 5 fjalësh, gjë e cila krijon kushte për biseda të vërteta. Fëmijët në këtë moshë po ashtu zhvillohen shpejt dhe ndryshe nga njëri-tjetri, ndërsa disa hapa zhvillimore gjuhësore te fëmijët me më shumë gjuhë zgjatin pak më gjatë. Prapambetjet e vogla megjithatë do të mund të kompensohen shpejt.

Kështu pra mund ta mbështetni fëmijën Tuaj në zhvillimin e gjuhës

■ *Përpiquni që vazhdimisht të krijoni rrethana për biseda të përbashkëta me fëmijën Tuaj.*

Flisni/bisedoni për librat me ilustrime dhe për përjetimet e përbashkëta. Parashtroni pyetje për gjërat të cilat fëmija Juaj është duke i rrefyer.

■ *Tani shërbehuni me fjali më të gjata dhe më të ndërlikuara.*

Sqarojani tani fëmijës Tuaj fjalët e panjohura.

■ *Përsëritni shprehjet e fëmijës Tuaj që janë me gabime dhe ato fjalë plotësoni edhe njëherë si duhet.*

Është me rëndësi që fëmijën Tuaj të mos e urdhëroni t'i përsërisë fjalët ose ta kritikoni atë. Kështu fëmija Juaj bisedën me kënaqësi do ta zhvillojë më tej.

Fëmija: „Vetula/Xina ka lëviz pejt.“

Prindi: „Saktë, vetura ka lëvizur shpejt.“